



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

**VENDIM**

Nr. 54, datë 08.10.2016

Për

Dhënie ndihme financiare familjes së **Z.Rrok Tom Gjohilani** për dëmtim shtëpie nga lagështira.

Këahillit të Bashkisë Vau Dejës i është paraqitur nga **Rrok Tom Gjohilani** kërkesa e datës 08.08.2016 ku i kërkohet mbështetje financiare për të përballuar dëmet e shkaktuara nga dëmtimi i shtëpisë nga lagështira gjatë viteve të fundit.

Kryetari i Bashkisë ka urdhëruar ngritjen e një grupi pune për vlerësimin në vend të situatës së banesës së këtij shtetasve.

Shkak i dëmtimit të shtëpisë është lagëshira, e vlerësuar nga Inxhinieri xheolog **Z.Tonin Vjerdha**, me Nr.liçense GJ 0332/1.

Shtëpia nuk është e siguruar në ndonjë agjensi sigurimesh, kjo sipas deklarimeve të kryefamiliarit. Familja përbëhet nga dy persona.

Kryetari i Bashkisë, bazuar në vlerësimin e grupit të ekspertëve, gjykoj dhënien si ndihmë financiare të shumës prej **20 mijë lekë** familjes së **Z. Rrok Tom Gjohilani**.

**Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:**

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji Nr.8756 datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave, Nr.263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore, financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimit Nr.4 datë 30.09.2015 i KM “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2015.

Bashkëngjitur projekt-vendimit është procesverbali i vlerësimit nga grupi i punës si dhe Raporti Gjeologo-Inxhinierik.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës për të përballuar dëmet e shkaktuara nga lagështira për banesën e **Z. Rrok Tom Gjohilani** e përbërë nga **2 (dy)** anëtarë, nga lagjia Dejë të Bashkisë Vau Dejës, e ndodhur ndër vite, i Këshilli i Bashkisë, në mbledhjen e datës 08.10.2016, me shumicë të cilësuar votash:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare familjes së **Z. Rrok Tom Gjohilani** të përbërë nga **2 (dy)** anëtar, në shumën **20 mijë lekë** për të përballuar dëmet e shtëpisë të shkaktuara nga lagështira gjatë viteve të fundit.
2. Burimi i financimit do të jetë fondi rezervë i cili do të planifikohet në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës për vitin 2016 .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Financës.
4. Ky vendim u shpall me datë 11/10/2016.

**SEKRETARI**  
**Gentian NDOJ**



**KRYETARI**  
**Martin MARKU**

